



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:264829

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05659508

C.nr.3882/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.B. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 274.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.B. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të shujtave ditore.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të shujtave ditore për vitin 2022, për periudhën kohore prej datës 03.01.2022 deri më 21.11.2022, për 137 ditë pune, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 274.00 euro, dhe atë me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (16.11.2023) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të shujtave ditore, vlera e kontestit 274.00 euro.

Në padi, ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune pranë ShFMU "Dy Dëshmorët" në fshatin Piranë, Komuna e Prizrenit. Pranë të paditurës ka qenë në punë në 137 ditë pune gjatë tërë vitit 2022, për periudhën kohore nga data 03.01.2022 deri më datë 21.11.2022. Paditëses i takon e drejta e kompensimit të shujtave ditore nga 2 euro për çdo ditë pune sipas kontratës kolektive të arsimit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se bazuar në

njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarës së të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditëses është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësja ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vërtetimit të prezencës në punë lëshuar nga ShFMU “Dy Dëshmorët” në fshatin Piranë, Komuna e Prizrenit, me numër protokollit 150/2023 i datës 07.11.2023, vërtetohet se paditësja për vitin 2022, nga data 03.01.2022 deri më 21.11.2022, ka realizuar gjithsej 137 ditë pune.

Meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili është i pranueshëm edhe për palën e paditur, gjykata ia fali besimin e plotë, duke u bazuar në nenin 329 par. 1 të LPK-së me të cilin është përcaktuar se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, rezultoi se e paditura ka detyrimin e pagesës në emër të ushqimit në punë, ngase përmes vërtetimit të prezencës në punë është vërtetuar se paditësja për vitin 2022, nga data 03.01.2022 deri më 21.11.2022, tek e paditura ka realizuar gjithsej 137 ditë pune, e që në rastin konkret të njëjtit i takon shuma prej 274.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 137 me 2.00 euro (137 ditë x 2.00 euro = 274.00 euro).

Këtë lloj kompensimi gjykata ia njohu paditësit në harmoni me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës

Kolektive të Arsimit në Kosovë me numër 01/B, numër të protokollit 105 e datës 22.01.2021, në të cilën kontratë parashihet se “të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”.

Nga provat e cekura më lartë dhe dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë çështjen e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës, gjykata erdhi në përfundim se paditësja e ka të drejtën që të kërkoj nga e paditura kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, respektivisht shujtave ditore.

Gjykata, pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi për pagesën e shujtave ditore i gjeti si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në ndonjë normë ligjore të aplikueshme apo bazë faktike. Paditësja në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton KKAK-ja, kurse mungesa e buxhetit të të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës së shqyrtimit kryesor të çështjes është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (16.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.3882/2023, datë 07.05.2023

Gjyqtari,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.